

Zhvillimi i Ekonomisë së Argjendit dhe Burimet përkatëse të qeverisë për të moshuarit Dokument Pozicioni

Lëshuar më 19 shtator 2022 nga
Rrjeti global i shoqatave dhe rrjeteve: Pensionistët që zhvillojnë ekonominë e argjendit
Përkthimi në shqip Aneta Mihali Xhiku

FJALËT KYÇE: jetëgjatësi; popullsia në plakje; plakje aktive; përdorimi i e-Teknologjive nga të moshuarit; shërbimet elektronike, Udhëzues për shërbime elektronike për të moshuarit mbi 55 vjeç; të mësuarit gjatë gjithë jetës; shkrim-lexim dixhital; e-learning; miqësi ndaj të moshuarve; përqëndrimi tek të moshuarit; ministri i të moshuarve; këshilli i të moshuarve; ekonomi e argjenditë.

RRJETI I PROPOZUAR

Të drejtat e pasigurta të të moshuarve, veçanërisht të atyre që janë me arsim të lartë dhe që pritet të këshillojnë dhe udhëzojnë brezat e rinj, kanë stimuluar krijimin ndërkombëtar të shoqatave avokuese dhe grupeve të liderëve të opinionit. Megjithatë, fuqia e këtyre grupeve ndryshon nga vendi në vend. Në disa vende, ato mbështeten dhe janë në qendër të një interesi intensiv; në të tjerat, ato praktikisht injorohen. Për këtë arsye ne besojmë se krijimi i një rrjeti i të gjitha këtyre shoqatave është thelbësor. Rrjeti i propozuar do të vepronte si mbështetje për politikën tashmë ekzistuese të Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, të ekspertëve të pavarur dhe të Aleancës Globale për të Drejtat e të Moshuarve. Që të tre kanë rekomanduar kohë më parë krijimin e një instrumenti të njohur për bashkimin e përpjekjeve që aktualisht janë të shpërndara. Rrjeti i propozuar, pra, do të kërkojë të nxisë shkëmbimin ndërkombëtar të ekspertizës përkatëse dhe do të përforcojë angazhimet dhe veprimet që shtetet e veçanta po ndërmarrin aktualisht për të përmbushur këto objektiva. Për shembull, ngjarje publike informative mund të organizohen për të promovuar iniciativën të veçanta mbështetëse, dhe për të ofruar një mundësi për anëtarët e rinj të rrjetit që të prezantohen. Rrjeti do të promovojë shëndetin për të moshuarit, parandalimin e sëmundjeve, lëvizshmërinë e të moshuarve, kohën e lirë të sigurt për të moshuarit, edukimin ushqimor, mbrojtjen nga rreziqet e reja, si dhe barazinë në shërbimet e nevojshme që të moshuarit të adoptojnë teknologjinë të reja informacioni dhe komunikimi.

Në rastin e anëtarëve akademikë në pension, rrjeti do të promovojë barazinë në lidhje me përdorimin e vazhdueshëm të teknologjive dixhitale (veçanërisht email), aksesin e vazhdueshëm në bibliotekat kërkimore, dhe aftësinë e garantuar për të moshuarit, për të financuar programet e tyre kërkimore dhe për të ofruar seminare falas.

EKONOMIA E ARGJENDTË

Koncepti i "ekonomisë së argjendit" mbulon një mori përpjekjesh të ndryshme, por të ndërlidhura. Së bashku këto mund të përmirësojnë cilësinë e jetës së të moshuarve, veçanërisht nivelet e përfshirjes së tyre në shoqëri dhe përfshirjen e tyre në aktivitetin ekonomik. Këto objektiva mund të përmbushen nëpërmjet zhvillimit të politikave, produkteve dhe shërbimeve inovative për plotësimin e nevojave të të moshuarve. Kjo, nga ana tjetër, do të sjellë më shumë rritje dhe vende pune për ekonominë e përgjithshme.

Koncepti i ekonomisë së argjendte kërkon të shikojë në mënyrë holistike plakjen dhe mundësitë që ajo paraqet në lidhje me drejtimin e ardhshëm të një game të gjerë politikash, si ato për ndërtimin e mjedisit, punësimin mbi 50 vjeç, mësimin gjatë gjithë jetës dhe kujdesin shëndetësor parandalues. Për më tepër, ai kërkon përqafimin e teknologjive të reja (p.sh. monitorimin e shëndetit, shtëpitë inteligjente, automjetet pa shofer, robotët e kujdesit) në mënyrë që t'i përdorë ato për të ulur kostot e plakjes dhe për të përmirësuar jetën e qytetarëve të moshuar, dhe në të njëjtën kohë, të nxisin ekonominë.

Dokumenti i parë i Komisionit Evropian mbi ekonominë e argjendte thekson rëndësinë e këtij koncepti. Për shkak të rritjes së jetëgjatësisë dhe nivelit të ulët të lindjeve, popullsia e BE-së po plakët ndjeshëm. Dokumenti, për shembull, parashikon që BE-ja do të kalojë nga situata kur në vitin 2013, për çdo person mbi 65 vjeç, punonin katër të rritur në moshë pune (15-64 vjeç,) në situatën që në vitin 2060, për çdo të moshuar, do të punojnë vetëm dy të rritur në moshë pune.

Një tjetër statistikë e raportuar zbulon të dhënat dramatike të një foshnje të lindur për çdo pesë të moshuar të gjallë. Megjithatë, sfidat e mëdha shpesh paraqesin mundësi unike. Dobësitë mund të kthehen në pika të forta duke përfunduar rrjetet dhe strukturën sociale. Së pari, është madhësia e ekonomisë së argjendte. Disa kanë llogaritur se nëse komuniteti i të rriturve mbi 50 vjeç do të ishte një shtet, ekonomia përkatëse do të ishte e treta më e madhja në botë, pas Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, por përpara Japonisë, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe. Së dyti, ekonomia e argjendte nuk i referohet një segmenti të vetëm të tregut kombëtar, por një ekonomie që pret disa segmente kryesore. Në të vërtetë, kontributet e popullsisë së moshuar ndikojnë në çdo treg dhe industri – duke përfshirë strehimin, transportin, industrinë ushqimore, sigurimet, robotikën, kujdesin shëndetësor, komunikimin (përfshirë internetin), sportet, kohën e lirë dhe udhëtimet. Rëndësia e këtij segmenti të popullsisë duhet të llogaritet edhe me anë të madhësisë së burimeve të tij. Në Itali, për shembull, një raport i Confindustria tregon se qytetarët mbi moshën 75 vjeç i ruajnë tani aftësitë gjuhësore dhe kujtesën shumë më mirë se grupet e së njëjtës moshë në të kaluarën. Si rezultat, ata përgjithësisht jetojnë në shtëpitë e tyre; kanë burime të kënaqshme ekonomike; kalojnë kohën e lirë duke shijuar pushime, hobi dhe aktivitete kulturore; dhe praktikojnë sporte. Kështu, ata kërkojnë mallra dhe shërbime dhe vazhdojnë të qarkullojnë paratë e tyre.

Megjithatë, për të siguruar që kontributet e tyre të vazhdojnë për aq kohë sa të jetë e mundur, shoqëria duhet të bëjë më shumë investime në kujdesin parandalues dhe jo vetëm në trajtimin e sëmundjeve. Shoqëria duhet gjithashtu të investojë në mjete dhe pajisje lëvizshmërie të qëndrueshme. Barrierat për pjesëmarrjen në aktivitetet sociale duhet të hiqen, dhe duhet të sigurohen mënyra preferenciale të aksesit dhe vende të sigurta të shpërndarjes së ushqimit. Disa nga nevojat e të moshuarve mund të adresohen përmes teknologjisë. Për shembull, me anë të Internetit të Gjërave, të moshuarit mund të vazhdojnë të jetojnë në shtëpitë e tyre ndërkohë që shëndeti i tyre monitorohet nëpërmjet një sërë sensorësh të lidhur. Mundësi të tjera përfshijnë aplikacione shëndetësore celulare që ndihmojnë në gjurmimin e shenjave jetësore të të moshuarve, produkte të reja ICT si robotika e kujdesit, dhe produkte të reja ushqimore të zhvilluara, për të adresuar nevojat ushqyese të të rriturve më të moshuar.

MINISTRIA E TË MOSHUARVE

Për të plotësuar nevojat e pjesës në rritje të të moshuarve të popullsisë do të kërkohen ndryshime në disa struktura sociale dhe ekonomike si dhe në organizimin qeveritar. Ekonomia e argjendte nuk do të krijohet vetvetiu. Kjo është arsyeja pse ne po propozojmë krijimin e një Ministrie të të Moshuarve në çdo vend në rrjet, për të ndihmuar në udhëheqjen dhe organizimin e ndryshimit. Deri më tani, vetëm shtatë vende (Australia, Kanadaja, Irlanda, Malta, Zelanda e Re, Skocia, Uells) kanë një ministër të tillë. Ministri i të moshuarve është personi kryesor përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e politikave që garantojnë

shërbime specifike të të moshuarve, si mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë. Përveç kësaj, ai ose ajo do të përfaqësojë të moshuarit si një anëtar i kabinetit, në mënyrë që ministrat e tjerë të kujtohen të marrin në konsideratë nevojat specifike të të moshuarve, ndërsa ata krijojnë dhe zbatojnë politika për ministratë e tyre - ministratë që kanë përgjegjësinë për fusha të tilla si shëndetësia, çështjet sociale, industria, mjedisi, arsimi dhe transporti. Me pak fjalë, të moshuarit duhet të kenë një zë të barabartë në tryezën e ministrave të qeverisë.

Ministri i të Moshuarve është i ngarkuar posaçërisht për të mbështetur dhe promovuar Ekonominë e Argjenditë. Ai ose ajo duhet të shikojë në mënyrë holistike plakjen e popullsisë dhe gjithashtu mundësitë dhe sfidat që ajo paraqet. Një sfidë e tillë, për shembull, do të jetë ngritja e nismave të përhershme arsimore, të cilat do të sigurojnë që qytetarët e moshuar të bëjnë zgjedhje të përgjegjshme për referendumet dhe petitionet, si ato që prekin teknologjitë e reja të disponueshme dhe sektorët e rinj të tregut, ashtu dhe ato në lidhje me përqindjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto kushtuar ekonomisë së argjenditë. Çështje të tjera të rëndësishme për të moshuarit do të jenë ato që ndikojnë në iniciativat parandaluese shëndetësore dhe ato që ndikojnë në shërbimet e aftësisë së kufizuar.

KËSHILLI I TË MOSHUARVE

Për koordinimin e aktiviteteve qeveritare në nivel kombëtar dhe lokal në lidhje me ekonominë e argjenditë, do të nevojitet gjithashtu një organ ndërqeveritar (një forum për të moshuarit) për të shkëmbyer informacione, për të diskutuar çështje të reja që lidhen me të moshuarit, dhe për të punuar me bashkëpunim në projektet kryesore.

Këshilli i të Moshuarve është një organ këshillimor dhe konsultativ pranë Ministrit të të Moshuarve ose Parlamentit. Qëllimi i tij është të mbështesë vendimmarrjen me më shumë pjesëmarrës. Në nivel lokal, këshilli mund të mbështesë vendimmarrjen lokale të informuar më mirë, duke ndihmuar në identifikimin e nevojave lokale, të cilat, nga ana tjetër, do të kontribuojnë në një shpërndarje më të mirë të burimeve të pakta.

Objektivat kryesore të Këshillit të të Moshuarve janë: përcaktimi i nevojave specifike të të moshuarve; promovimi dhe zbatimi i aktiviteteve dhe projekteve të konceptuara për mirëqenien e të moshuarve; këshillimi i qeverisë për çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien e të moshuarve; mbajtja e komunikimit efektiv qeveritar me të moshuarit; dhe vendosja dhe mbajtja e kontakteve me organizatat e angazhuara në aktivitete të ngjashme në vend.

Ndikimi i Këshillit të të Moshuarve ka të ngjarë të rritet gjatë viteve të ardhshme, duke pasur parasysh plakjen e popullsisë dhe rëndësinë në rritje të qytetarëve të moshuar në elektorat. Këshillat janë një mjet organizativ për të dhënë udhëzime për zhvillimin e ekonomisë së argjenditë, në përputhje me nevojat dhe dëshirat e të moshuarve. Me pak fjalë, ata promovojnë përqëndrimin tek të moshuarit.

NËNSHKRUESIT MARRIN PËRSIPËR TË BËJNË SË MË POSHTË NË MJEDISIN E TYRE:

- o Të shpërndajnë këtë dokument pozicioni midis organizatave përkatëse lokale.
- o Të marrin pjesë në fushata që kontribuojnë në realizimin e ideve dhe propozimeve tona.
- o Të inkurajojnë dhe përfshihen në bashkëpunimin elektronik ndërkuftar.
- o Të promovojnë ngjarjet që mbështesin aktivitetet e Rrjetit si dhe rritjen e numrit të grupeve të lidhura në rrjet.
- o Të publikojnë gjetjet mbi veprimet për zbatimin e këtyre ideve dhe sugjerojnë veprime të reja bazuar në përvojën e fituar.